



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1278/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Zethane Sefedini, kandidate për anëtare të kuvendit komunal, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it me Anr. 1118/2013 i datës 06.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i Zethane Sefedini, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.12.2013, nga Zethane Sefedini, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkon që të bëhet ri shqyrtimi i vendimit 1118/2013 të 03.12.2013, me të cilin ishte refuzuar nga ana e PZAP-it dhe pretendon se paneli nuk kishte vepruar sipas ankesës ankimore për rinumërimin e votave në vendvotimet për të cilat ka kërkuar.

Apeli i ka bashkangjitur në cilësi të provave deklaratat e votuesve të saj të dt. 03.12.2013.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi e apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se apeli është i pabazuar, ngase parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi më të cilin do të vërtetohen pretendimet ankimore ndaj vendimit Anr.1118/2013 i datës 06.12.2013.

Duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se :”Pranon ankesat/apelet e bazuara në faktë dhe refuzon ankesat/apelet, të cilat nuk përmbushin standardet”. Andaj duke u bazuar ne arsyet e lart cekuara si dhe ne dispozitën e sipërshnuar PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1278/2013 më datën 13.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.